



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 18 gusht 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

U miratuan “Rregullat për regjistrimin pranë ERE-s të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike”.

U vendos zgjatja e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me kërkesën e shoqërisë “BUSHTRICA 2017” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

U vendos fillimi i procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

U miratua kërkesa e shoqërisë “HEC VLUSHE” sh.p.k. për vendosjen e kuotave të saj si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredithënëse “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a.

U miratua kërkesa e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e aseteve të “HEC Arcovë” si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a.

U miratuan disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 44, datë 11.02.2026, dhënë në lidhje me ndryshimin e ortakut kryesor që kontrollon interesat e shoqërisë “PARISOL” sh.p.k.

Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare.